REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISË



# EKONOMIA DHE BUXHETI

*NENTOR, 2010*

# Raporti Mujor

## Nëntor, 2010

*Kontakt:*
*Telefon: ++355 (4) 228 1009*
*e-mail: elami@minfin.gov.al*
www.minfin.gov.al

# PËRMBAJTJA

VEÇORITË KRYESORE ....................................................................2

ZHVILLIMET EKONOMIKE....................................................................3

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit 3
2. Kursi mesatar i këmbimit 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave 5
4. Bilanci i Pagesave 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar 7
6. Kredia për Ekonominë 7
7. Oferta e Parasë 8
8. Depozitat sipas Burimeve 9

SEKTORI FISKAL.................................................................................... 10

1. Buxheti i Konsoliduar 10
2. Të Ardhurat sipas Burimeve 11
3. Financimi i Bilancit Fiskal 11

ANEKSI STATISTIKOR ............................................................................ 12

# VEÇORITË KRYESORE

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin Nëntor, 2010 arriti në 107.2 përqind
- *Norma vjetore e inflacionit* për muaji Nëntor ishte 2.8 përqind
- *Kursi mesatar i këmbimit* të monedhes vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Nëntor 2010 ishte 101.33 lekë për dollarë dhe 138.82 lekë për euro
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit Nëntor shënuan kuotat 6.82 përqind për depozitat 24 mujore, 6.15 për ato 12 mujore, 5.22 për 6 mujorët dhe 4.49 perqind per depozitat 3 mujore
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 11.85 përqind për huatë 12 mujore dhe 11.25 për ato 6 mujore
- *Oferta totale e parasë*, e matur nga agregati M3, arriti në 961.4 miliardë lekë në muajin Nëntor, duke shënuar një rritje prej rreth 12.0 përqind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë
- *Bilanci i pagesave* për 6-mujorin e parë të vitit 2010 rezultoi me një defiçit të përgjithshëm prej 3.1 milion euro.
- *Situata Buxhetore* për periudhën Janar - Nëntor 2010 rezultoi me një defiçit të përgjithshëm prej rreth 23.1 miliardë lekë.
- *Të ardhurat gjithsej* të realizuara gjatë periudhës Janar - Nëntor të viti 2010, arriti në rreth 293.4 miliardë lekë, ose rreth 98.2 përqind e planit për periudhën.
- *Shpenzimet gjithësej* gjatë së njëjtës periudhë, arritën në rreth 316.5 miliardë lekë, ose rreth 94.3 përqind e shpenzimeve të planifikuara për periudhën.

# ZHVILLIMET EKONOMIKE

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Nëntor 2010 pësoi një rritje prej 0.2 përqind krahasuar me muajin Tetor dhe Shtator ‘10, kur ky indeks shënonte përkatësisht 0.2 përqind dhe 0.7 përqind. Ndryshimet respektive në të njëjtët muaj të një viti më parë ishin 0.4 përqind, 0.4 përqind dhe 0.8 përqind. Rritja me e madhe mujore, gjatë muajit Nëntor u konstatua në grupin “Ushqime dhe pije joalkolike” me 0.3 përqind. Pesha specifike relativisht e lartë që zë ky grup në shportën e mallrave të konsumit, bën që ndryshimet e çimimeve për këtë grup të kenë efekte mbi normën e inflacionit.

Gjatë këtij muaji rënie prej -0.1 % e pësoi indeksi i cmimit te grupit “Pije alkolike dhe duhan”.

Graf - 1




***Ndryshimet mujore të IÇK-së***

Burimi: INSTAT

Tab - 1 ***Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)***

| *VITI* | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ***2009*** | 2.1 | 1.9 | 1.6 | 1.9 | 2.1 | 2.3 |
| ***2010*** | 4.1 | 4.4 | 3.9 | 3.5 | 3.1 | 3.2 |
| *VITI* | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |
| ***2009*** | 2.2 | 2.2 | 2.0 | 2.3 | 2.8 | 3.5 |
| ***2010*** | 3.4 | 3.5 | 3.4 | 3.0 | 2.8 | |

*Burimi: INSTAT*

Norma vjetore e inflacionit në muajin Nëntor arriti në 2.8 përqind duke qëndruar brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitet 2009 dhe 2010 paraqiten në tabelën 1.

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt Euros në muajin Nëntor 2010, arriti në 138.82 Lekë/Euro, duke shënuar një rritje prej 0.3 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Nëntor një euro u këmbye me 138.65 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Nëntor 2010, arriti në 101.33 lekë/dollarë duke shënuar një rritje prej 1.7 përqind kundrejt muajit Tetor.

Graf - 2




***Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit Nentor '10***

Në fund të muajit Nëntor, dollari amerikan arriti nivelin 106.49 lekë/dollarë. Në krahasim me muajin Nëntor të vitit të kaluar rezulton se monedha shqiptare është zhvlerësuar ndaj dollarit amerikan në masën 9.7 përqind dhe është zhvlersuar kundrejt monedhës europiane, Euro, me 0.8 përqind. Nëncmimi i lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane Euro dhe monedhës amerikane, në rradhë të parë është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan pësoi një rritje mesatare duke arritur në rreth 1.370 euro/dollarë.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtjen e ritmeve pozitive të ekonomisë në vend, efikasitet te politkës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

# 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Nëntor 2010, normat e interesit të depozitave 12-mujore në lekë arritën kuotën e 6.15 përqind, duke shënuar një rënie prej 0.16 përqind krahasuar me muajin Tetor. Rënie për këtë muaj kanë pësuan depozitat me afat 6-mujor dhe 1-mujor të krahasuara me muajin paraardhës, respektivisht me 0.03 dhe 0.09 përqind. Normat e interesit për depozitat me afat 3-mujor pësuan rritje me 0.08 përqind krahasuar me muajin paraardhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë pësuar normat e interesit të depozitave me afat 12, 6 dhe 3 mujore. Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit Nëntor pësoi një rënie me 0.24 pikë përqind, duke arritur në 11.85 përqind nga 12.09 përqind që ishte në muajin Tetor. Për këtë muaj norma e interesit të huave 6-mujore pësuan një rënie prej 0.32 pikë përqind krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin Nëntor arriti në 11.25 përqind. Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit Nëntor 2010, për bonot me maturim 12 mujor, 6 mujor dhe 3 mujor ishin përkatësisht 7.55 përqind, 6.70 përqind dhe 5.51 përqind. Gjatë këtij muaji vihet re një rënie në Yield-et e bonove të thesarit për afatet e maturimit 12 dhe 6–mujore.

Graf - 3




*Normat e interesit për depozitat*

Graf - 4




*Normat e interesit për huatë*

# 4. Bilanci i Pagesave

Graf - 5




***Bilanci i Pagesave***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Bilanci i pagesave për periudhën Janar – Qershor 2010 regjistroi nje defiçit të përgjithshëm prej 3.1 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në grafikun 5.

Graf - 6




***Llogaria Korente***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Kompozicioni i defiçitit të llogarisë korente prej 460.07 milion euro i shprehur sipas elementëve kryesorë përbërës (ne terma neto) për periudhën Janar'10 - Qershor'10 rezultoi:

*(i)* bilanci tregtar -901.94 mln euro, *(ii)* shërbime neto -19.04 mln euro, *(iii)* të ardhura neto -34.91 mln euro, (iv) transferta neto 495.82 mln euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet ne grafikun 6.

## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Nëntor 2010, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), në rreth 93,180.6 milionë lekë krahasuar me fundvitin 2009. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes të mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë me rreth 39,255.4 milionë lekë dhe të rritjes së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë, me rreth 59,925.2 milionë lekë. Në muajin Nëntor sistemi bankar rezulton me një rritje prej 15,198.0 milionë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin Tetor '10, rritje e cila erdhi si rezultat i rënies së nivelit të mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 5,285.0 milionë lekë si dhe të rritjes së mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë, me rreth 20,483.0 milionë lekë.

Graf - 7




***Ecuria e M.V.N. te sistemit në Nen'09-Nen'10***

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 6. Kredia për Ekonominë

Teprica e kredisë për ekonominë për muajin Nëntor 2010 arriti në 475.9 miliardë lekë. Rritja e tepricës së kredisë, krahasuar me muajin Tetor shënoi vlerën 13.6 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 2.9 përqind. Nga struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizoterohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 67.5 përqind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 321 miliardë lekë.
Këtë muaj pesha specifike e kredive për individët, arriti në nivelin 31.1 përqind.

# 7. Oferta e Parasë

Graf-8




***Agregati M3 Nen '09-Nen '10***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin Nëntor ka shënuar një rritje krahasuar me muajin paraardhës Tetor 2010. Kjo ofertë arriti në rreth 961 miliardë lekë në fund të muajit Nëntor duke shënuar një rritje prej 9.3 miliardë lekë kundrejt nivelit të rregjistruar në muajin Tetor. Rritja vjetore e këtij treguesi ishte 12.0 përqind, duke ruajtur kështu tendencën rritëse të shfaqur që nga mesi i vitit të kaluar.

Graf-9




***Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare, kanë pësuar një rritje prej 3.2 milionë lekë në krahasim me muajin Tetor.

Graf-10




***Raporti i Depozitave ndaj M3***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë gjatë muajit Nëntor, janë mbështetur kryesisht nga depozitat e sektorit privat, të cilat kanë përbërë rreth 81.0 përqind të depozitave totale në valutë.

## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Nëntor 2010 “sektorë të tjerë rezident”, zuri nivelin më të lartë të depozitave të trasferueshme në lekë, me rreth 58.8 përqind, ndjekur nga “korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 27.1 përqind dhe nga “korporata publike jofinanciare”, me 11.4 përqind. “Sektorë të tjerë rezident” dhe “korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhe të huaj, përkatësisht me rreth 81.0 përqind dhe rreth 15.4 përqind. “Sektorë të tjerë rezident” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i Depozitave të tjera në lekë (95.9 përqind e totalit)

Në përgjithësi, “Sektorë të tjerë rezident” përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 656 miliarde) të depozitave totale, prej rreth 772 miliardë lekë në muajin Nëntor 2010. Ata ndiqen nga “korporata të tjera jofinanciare” (85.8 miliardë), “korporatat të tjera financiare publike” (17.0 miliardë) dhe “korporata jofinanciare publike” (10.8 miliardë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 1.5 miliardë në totalin e depozitave.

**Graf - 11**




***Përberja e depozitave***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit Nëntor 2010, krahasuar me nje muaj më parë Tetor niveli i përgjithshëm i depozitave u rrit me 10.9 miliardë lekë, si rezultat i rritjes së depozitave në lekë dhe të atyre në valutë .

# SEKTORI FISKAL

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar - Nëntor 2010 janë mbledhur rreth 293.4 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 316.5 miliardë lekë, që përfshijne 266.7 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 54.5 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 71 % financim i brëndshëm, dhe 29 % financim i huaj.

Graf - 12




***Treguesit Fiskal, Janar-Nentor 2010***

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 88 % të të ardhurave buxhetore për vitin 2010, ndërsa shpenzimet përbëjnë 85.1 % të buxhetit të planifikuar. Shpenzimet korrente janë rreth 88.4 % e planifikimit vjetor, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 82.6 % e këtij planifikimi.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave është rreth 201.5 miliardë lekë (ose rreth 87.7 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 10.6 miliardë lekë (68.6 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 49.2 miliardë lekë (91.3 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), dhe të ardhurat jo - tatimore në nivelin e 29.4 miliardë lekë (103.9 % e të ardhurave vjetore të planifikuara). Nga totali i shpenzimeve korrente prej 266.7 miliardë lekë, 58.8 miliardë lekë (22.1 % e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, 37.2 miliardë lekë (13.9 %) për interesat, 29.2 miliardë lekë (11 %) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 3.4 miliardë lekë (1.3 %) për subvencione, 95.6 miliardë lekë (35.8 %) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore dhe 26.5 miliardë lekë (9.9 %) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 16.1 miliardë lekë (6 %) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 88 % (shpenzime personeli), 85.4 % (shpenzime për interesat), 94.8 % (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 182.7 % (subvencione), 87.8 % (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 87 % dhe 82.9 % (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) përkundrejt buxhetit të planifikuar vjetor. Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë llogariten në rreth 71 % të buxhetit të parashikuar vjetor, ndërsa financimi i huaj është vetëm 29 %.

## 2. Të Ardhurat sipas Burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Nëntor 2010 ishin rreth 293.4 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 261.3 miliardë, të ardhurat jo - tatimore në rreth 29.4 miliardë

Tab - 2 ***Të ardhurat e realizuara në Nëntor 2010***

| Burimi | Miliardë Lekë |
|---|---|
| TVSH | 103.2 |
| Tatimi mbi fitimin | 15.9 |
| Taksa doganore | 6.5 |
| Taksat nacionale | 16.8 |
| Akcizat | 34.8 |

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Defiçiti prej 23.1 miliardë lekë, për periudhën Janar - Nëntor 2010, u mbështet në vlerën 14.7 miliardë lekë nga burime të brëndshme dhe 8.4 miliardë lekë me financim të huaj. Emetimi i bonove të thesarit ishte mjeti kryesor i financimit të brendshëm, ndërsa për financimin e huaj ishin huatë afatgjata.

Për periudhën Janar - Nëntor 2010, disa nga treguesit kryesorë fiskal ishin:

- Realizimi i Të Ardhurave në masën 293.4 miliardë lekë.
- Realizimi i Shpenzimeve ne masën 316.5 miliardë lekë

Në realizimin e të ardhurave për këtë periudhe kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga Tatimet dhe Doganat të cilat kapin shifrën e 201.5 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 266.7 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 54.5 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

**Tab - 1**

| | Mujor (Monthly | | | | | Mesatar Mujor (Monthly Average) | | | | | Vjetor (Annual) | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Muaji | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | **2010** | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | **2010** | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | **2010** | Month |
| Janar | 0.2 | 0.5 | 0.5 | 0.4 | 0.9 | 0.20 | 0.50 | 0.50 | 0.40 | 1.00 | 1.4 | 2.9 | 3.0 | 2.1 | 4.3 | January |
| Shkurt | 0.4 | 0.5 | 1.0 | 0.7 | 1.1 | 0.30 | 0.50 | 0.75 | 0.55 | 1.02 | 1.3 | 2.9 | 3.6 | 1.9 | 4.7 | February |
| Mars | 0.1 | -0.1 | 0.9 | 0.6 | 0.1 | 0.23 | 0.30 | 0.80 | 0.57 | 0.71 | 1.5 | 2.7 | 4.6 | 1.6 | 4.1 | March |
| Prill | 0.6 | -0.2 | -0.4 | -0.1 | -0.4 | 0.33 | 0.18 | 0.50 | 0.40 | 0.42 | 2.4 | 1.9 | 4.4 | 1.9 | 3.7 | April |
| Maj | -0.4 | -0.8 | -1.0 | -0.8 | -1.2 | 0.18 | -0.02 | 0.20 | 0.16 | 0.10 | 3.1 | 1.4 | 4.2 | 2.1 | 3.3 | May |
| Qershor | -1.1 | -0.6 | -0.8 | -0.6 | -0.7 | -0.03 | -0.12 | 0.03 | 0.03 | -0.04 | 2.4 | 2.0 | 4.0 | 2.3 | 3.2 | June |
| Korik | -0.4 | -0.3 | -0.6 | -0.7 | -0.5 | -0.09 | -0.14 | -0.06 | -0.07 | -0.10 | 3.2 | 2.1 | 3.7 | 2.2 | 3.4 | July |
| Gusht | -0.2 | 1.9 | 0.6 | 0.7 | 0.8 | -0.10 | 0.11 | 0.03 | 0.03 | 0.01 | 2.8 | 4.2 | 2.5 | 2.2 | 3.5 | August |
| Shtator | 0.6 | 0.9 | 1.1 | 0.8 | 0.7 | -0.02 | 0.20 | 0.14 | 0.11 | 0.09 | 2.6 | 4.4 | 2.7 | 2.0 | 3.4 | September |
| Tetor | 0.1 | -0.1 | 0.1 | 0.4 | 0.2 | -0.01 | 0.17 | 0.14 | 0.14 | 0.10 | 2.2 | 4.2 | 2.8 | 2.3 | 3.0 | October |
| Nendor | 0.9 | 0.2 | -0.1 | 0.4 | 0.2 | 0.07 | 0.17 | 0.12 | 0.16 | 0.16 | 2.9 | 3.5 | 2.6 | 2.8 | 2.8 | November |
| Dhjetor | 1.8 | 1.3 | 0.9 | 1.6 | | 0.22 | 0.27 | 0.18 | 0.28 | | 2.5 | 3.1 | 2.2 | 3.7 | | December |

*Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë* *Source : INSTAT,Bank of Albania*

**Tab - 2** **Kursi i kembimit**
Exchange rate

Leke per njesi te monedhes se huaj *(Leke per unit of foreign currency)*

| Monedha | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 Jan | Feb | Mar | Apr | May | Jun | Jul | Aug | Sep | Oct | **Nov** | Currency |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Mesatarja e periudhes* | | | | | | | | | | | | | | | | *Average of period* |
| USD | 98.10 | 90.43 | 83.89 | 94.98 | 96.84 | 101.34 | 102.51 | 103.02 | 108.73 | 111.89 | 106.63 | 105.59 | 104.81 | 99.60 | 101.33 | USD |
| EURO | 123.08 | 123.63 | 122.80 | 132.06 | 138.28 | 138.80 | 139.20 | 138.36 | 136.72 | 136.65 | 136.11 | 136.24 | 137.05 | 138.39 | 138.82 | EURO |
| *Fundi i periudhes* | | | | | | | | | | | | | | | | *In the end of period* |
| USD | 93.67 | 82.89 | 87.91 | 95.81 | 99.60 | 102.15 | 103.31 | 103.42 | 111.63 | 111.44 | 105.03 | 108.13 | 101.46 | 100.23 | 106.49 | USD |
| EURO | 123.70 | 121.78 | 123.80 | 137.96 | 139.08 | 138.89 | 139.05 | 137.63 | 137.26 | 136.45 | 136.61 | 137.11 | 138.45 | 138.62 | 138.65 | EURO |

*Burimi : Banka e Shqiperise* *Source : Bank of Albania*

Tab - 3

**Normat e interesit me baze vjetore**
Annual Interest Rates

| Ne perqindje / Fundi I periudhes | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 Janar Jan | Shkurt Feb | Mars Mar | Prill Apr | Maj May | Qershor Jun | Korrik Jul | Gusht Aug | Shtator Sep | Tetor Oct | **Nentor Nov** | In percent / End of period |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Norma e remunerimit** | | | | | | | | | | | | | | | **Remuneration rate** |
| ne leke | 4.37 | 4.37 | 3.67 | 3.67 | 3.67 | 3.67 | 3.67 | 3.67 | 3.67 | 3.67 | 3.50 | ... | ... | ... | In Lek |
| ne usd | 3.40 | 0.70 | 0.09 | 0.09 | 0.09 | 0.09 | 0.09 | 0.09 | 0.09 | 0.09 | 0.09 | ... | ... | ... | In USD |
| ne euro | 3.11 | 2.28 | 0.70 | 0.70 | 0.70 | 0.70 | 0.70 | 0.70 | 0.70 | 0.70 | 0.70 | ... | ... | ... | in EURO |
| **Norma e depozitave** | | | | | | | | | | | | | | | **Deposits rates** |
| 12-M | 5.67 | 6.93 | 6.78 | 6.77 | 6.74 | 6.60 | 6.59 | 6.46 | 6.39 | 6.39 | 6.29 | 6.27 | 6.31 | 6.15 | 12-M |
| 6-M | 4.83 | 5.72 | 5.74 | 5.57 | 5.64 | 5.48 | 5.45 | 5.43 | 5.42 | 5.46 | 5.24 | 5.25 | 5.25 | 5.22 | 6-M |
| 3-M | 4.12 | 5.13 | 5.05 | 5.06 | 4.94 | 4.67 | 4.75 | 4.73 | 4.62 | 4.48 | 4.49 | 4.56 | 4.41 | 4.49 | 3-M |
| 1-M | 3.83 | 4.30 | 4.56 | 4.48 | 4.40 | 4.52 | 4.63 | 4.69 | 4.79 | 4.68 | 4.58 | 4.36 | 4.40 | 4.31 | 1-M |
| **Norma e huase** | | | | | | | | | | | | | | | **Lending rates** |
| 12-M | 11.73 | 11.75 | 12.46 | 12.24 | 12.28 | 12.66 | 12.37 | 12.98 | 11.77 | 11.48 | 8.09 | 11.77 | 12.09 | 11.85 | 12-M |
| 6-M | 14.11 | 12.85 | 12.54 | 12.37 | 13.66 | 16.43 | 14.81 | 14.99 | 12.80 | 11.83 | 11.70 | 10.76 | 11.57 | 11.25 | 6-M |
| **Norma e letrave me vlere** | | | | | | | | | | | | | | | **Securities rates** |
| Bobo thesari 1/ | | | | | | | | | | | | | | | Treasury bills 1/ |
| 3-M | 6.48 | 6.27 | 6.30 | _ | 6.27 | 6.22 | 6.04 | 5.90 | 5.86 | 5.86 | 5.74 | 5.59 | ... | 5.51 | 3-M |
| 6-M | 7.51 | 7.45 | 7.52 | 7.48 | 7.46 | 7.39 | 7.30 | 7.15 | 7.12 | 7.11 | 7.03 | 6.98 | 6.80 | 6.70 | 6-M |
| 12-M | 8.41 | 8.56 | 9.14 | 8.99 | 8.88 | 8.65 | 8.44 | 8.01 | 7.91 | 7.94 | 7.86 | 7.75 | 7.71 | 7.55 | 12-M |

*Burimi : Banka e Shqiperise* *Source : Bank of Albania*

Tab - 4 **TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR 2010**
Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2009

*Te dhena progresive (Progresive Data)* — *ne milion leke (in millio*

| Nr. | E M E R T I M I | Nentor Nov | ITEM |
|---|---|---|---|
| | **TOTALI TE ARDHURAVE** | **293,448** | **TOTAL REVENUE** |
| **I.** | **Ndihma** | **2,777** | **Grants** |
| **II.** | **Te ardhura tatimore** | **261,308** | **Tax Revenue** |
| **II.1** | **Nga Tatimet dhe Doganat** | **201,486** | **From tax offices and customs** |
| 1 | Tatimi mbi Vleren e Shtuar | 103,242 | V. A. T |
| 2 | Tatimi mbi Fitimin | 15,925 | Profit Tax |
| 3 | Akcizat | 34,833 | Excise Tax |
| 4 | Tatimi mbi te Ardhurat Personale | 24,211 | Personal Income Tax |
| 5 | Taksa Nacionale dhe te tjera | 16,830 | National Taxes and others |
| 6 | Taksa Doganore | 6,445 | Custom Duties |
| **II.2** | **Te ardhura nga Pushteti Lokal** | **10,621** | **Revenues from Local Gov.** |
| 1 | Tatimi mbi pasurine | 1,795 | Tax on land |
| 2 | Tatimi mbi Biznesin e vogel | 2,256 | Small Business Tax |
| 3 | Taksa lokale | 6,570 | Local Taxes |
| **II.3** | **Te ardh Buxh. Pavarur** | **49,202** | **Social ins** |
| 1 | Sigurimi Shoqeror | 41,361 | Social Insurance |
| 2 | Sigurimi Shendetsor | 5,914 | Health insurance |
| 3 | Te ardhura per kompensim ne vlere te pronareve | 1,927 | |
| **III.** | **Te ardhura Jotatimore** | **29,363** | **Nontax Revenue** |
| 1 | Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise | 4,486 | Profit transfer from BOA |
| 2 | Te ardhura nga Inst.Buxhetore | 12,937 | Income of budgetary institutions |
| 6 | Dividenti | 578 | Divident |
| 7 | Tarifa sherbimesh | 2,749 | Services |
| 8 | Te tjera dhe interesa | 8,613 | Other/not allocated |
| | **TOTALI I SHPENZIMEVE** | **316,505** | **TOTAL EXPENDITURE** |
| **I.** | **Shpenzime Korrente** | **266,649** | **Current Expenditures** |
| **I.1** | **Personeli** | **58,818** | **Personnel expenditures** |
| 1 | Paga | 50,857 | Wages |
| 2 | Kontributi per Sigurime Shoqerore | 7,961 | Social insurance contributions |
| **I.2** | **Interesat** | **37,156** | **Interest** |
| 1 | Te Brendshme | 31,529 | Domestic |
| 2 | Te Huaja | 5,627 | Foreign |
| **I.3** | **Shpenzime Operative Mirembajtje** | **29,221** | **Operational & Maintenance** |
| **I.4** | **Subvencionet** | **3,352** | **Subsidies** |
| **I.5** | **Shpenzime per Sig.Sociale dhe te tjera** | **95,576** | **Social insurance outlays** |
| 1 | Sigurime Shoqerore | 71,222 | Social insurance |
| 2 | Sigurime Shendetsore | 22,604 | Health insurance |
| 3 | Shpenzime per kompensime ne vler te pronarve | 1,750 | |
| **I.6** | **Shpenzime per Buxhetin Lokal** | **26,446** | **Local Budget** |
| **I.7** | **Shpenzime te tjera** | **16,080** | **Other expenditures** |
| 1 | Pagesa e Papunesise | 941 | Unemployment insurance benefits |
| 2 | Ndihma Ekonomike | 15,137 | Social assistance |
| **III.** | **Shpenzime Kapitale** | **54,532** | **Capital expenditures** |
| 1 | Financimi Brendshem | 38,641 | Domestically financing |
| 2 | Financimi Huaj | 15,891 | Foreign financed |
| **IV** | **Huadhenje KESH** | **-4,676** | **CASH Lending** |
| | **DEFIÇITI** | **-23,057** | **Deficit** |
| | **FINANCIMI DEFIÇITIT** | **23,057** | **Deficit Financing** |
| | **Brendshem** | **14,640** | **Domestic** |
| | Te ardhura nga privatizimi | 265 | Privatization receipts |
| | Hua-marrje e brendeshme | 41,683 | Domestic Borrowing |
| | Huamarje e brendshme nacionale nga te cilat: | 41,615 | |
| | *EuroBono* | 14,664 | **Euro-Bono** |
| | *Eurobondi emetime* | 41,364 | Alpha bank |
| | *Ripagesa e kredise tregtare* | 26,700 | Directly from BoA |
| | Huamarje e brendshme vendori | 68 | |
| | Te tjera | -27,309 | Other |
| | Depozite e Qeverise ne Banken e Shqiperise | -27,601 | Government deposit at the BoA |
| | Te tjera | 293 | |
| | **I Huaj** | **8,417** | **Foreign** |
| | Hua afatgjate(e marre) | 16,646 | Long-term Loan(Drawings) |
| | *nga e cila nenhua* | 3,801 | |
| | Ndryshimi i gjendjes se arkes* | -3,018 | Chang. of stat. Account* |
| | Ripagesat | -5,211 | Repayments |
| | **KAPITUJT KRYESORE** | | **Main indicators** |
| | Financimi i Brendshem i Defiçitit | 14,639 | Domestically financed deficit |
| | Defiçiti Pergjithshem | -23,056 | Overall Balance |
| | Te ardh.-Shpen.nga Sig. Shoq.dhe Shend. | -44,624 | Soc.& health insur.contr.-outlays |

* *"Ndryshimi i gjendjes se arkes" perfaqeson ndryshimin ne Depozites se Financimeve te Huaja*

*"Chang. of stat. Account" stands for the change in Foreign Financing Deposit*

*Te dhena operative* — *preliminary data*

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2010**

Table of investments 2010

*Te dhena progresive (Progresive Data)* *ne milion leke( in million leks)*

| | Nentor<br>Nov | |
|---|---|---|
| **Financim i brendshem** | **38,641** | **Domestic financing** |
| *Ne %* | *70.86%* | *In %* |
| **Financim i huaj** | **15,891** | **Foreign financing** |
| *Ne %* | *29.14%* | *In %* |
| **Totali** | **54,532** | **Total** |
| *Ne %* | *100.00%* | *In %* |

Tab - 6

**TE ARDHURAT NGA ZYRAT E DOGANAVE 2010**
**REVENUES FROM CUSTOMS OFFICE 2010**

*Te dhena progresive (Progresive Data)* *ne milion leke( in million leks)*

| | Nentor<br>Nov | |
|---|---|---|
| Takse doganore | 6,445 | Customs Duties |
| TVSH | 76,340 | V.A.T |
| Akcize | 22,094 | Excises |
| Te tjera | 1,993 | Others |
| **TOTALI I DOGANAVE** | **106,872** | **Total from customs office** |
| **TE ARDHURAT TATIMORE NGA ZYRAT E TATIMEVE DHE INSTITUCIONET BUXHETORE** | | |
| **TAX REVENUES FROM TAX OFFICE AND OTHER INSTITUTIONS** | | |
| TVSH | 26,902 | V.A.T |
| Akciza | 12,739 | Excises |
| Tatimi mbi fitimin | 15,925 | Profit Tax |
| Tatimi mbi te ardhurat personale | 24,211 | Personal income tax |
| Takse nacionale | 14,837 | National taxes |
| Lojrat e fatit dhe kazinote | | Tax on Gamble & Casino |
| **TOTALI I TATIMEVE** | **94,614** | **Total from tax office** |
| **TOTALI I PERGJITHSHEM** | **201,486** | **Total Tax Office** |

Tab - 7

**DEFICITI DHE FINANCIMI PER 2010**

The Deficit and Its Financing for 2010

*Te dhena progresive (Progresive Data)* *Ne milion leke (In million Leks)*

| | Nent<br>Nov | |
|---|---|---|
| **Totali i te Ardhurave** | **293,448** | **Total Revenues** |
| **Totali i Shpenzimeve** | **316,505** | **Total Expenditures** |
| **Deficiti** | **-23,057** | **Cash-Balance** |
| | | |
| **Financimi i deficitit** | **23,057** | **Financing** |
| **1. I BRENDSHEM** | **14,640** | **Domestic** |
| a. Bono thesari | 41,683 | Treasury bills |
| b. Eurobono | 41,615 | Eurobonds |
| huamarje e brendshme vendori | **68** | Local Domestic Loan |
| Depozitat e qev. ne Banken e Shqip. | -25,949 | Deposit of Government in B.O.A |
| **f. Te ardhura nga privatizimi** | **265** | **Privatization receipts** |
| **g. Te tjera detyrime** | **-1,357** | **Others** |
| **2.I JASHTEM** | **8,417** | **Foreign** |
| a. Hua afatgjate | 16,646 | Long-term Loan |
| -Marre | 3,801 | Drawings |
| -Shlyer (Ripagesat) | -5,211 | Repayments |
| b. Ndryshimi i gjendjes se arkes | -3,018 | Chang.of stat. account |

Tab - 8

**BILANCI I PAGESAVE**
Balance of payments

*Ne milion Euro* In millions Euro

| | 3M_I 2009 | 3M_II 2009 | 3M_III 2009 | 9M_2009 | 3M_I 2010 | 3M_II 2010 | 3M_III 2010 | 9M_2010 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Llogaria korente** | **-326.48** | **-311.33** | **-383.05** | **-1,020.86** | **-246.60** | **-216.63** | **-209.50** | **-672.73** | **Current Account.** |
| **Bilanci tregetar** | **-516.77** | **-579.01** | **-606.57** | **-1,702.35** | **-419.01** | **-482.93** | **-595.90** | **-1,497.84** | **Trade Balance.** |
| Eksporti I mallrave fob | 175.73 | 183.44 | 186.00 | 545.17 | 254.91 | 340.47 | 270.30 | 865.68 | Merchandise Exports. Fob |
| Importi I mallrave fob | -692.50 | -762.45 | -792.57 | -2,247.52 | -673.92 | -823.40 | -866.20 | -2,363.52 | Merchandise Imports. Fob |
| **Bilanci i sherbimeve** | **-21.15** | **-18.57** | **126.18** | **86.46** | **-19.27** | **-0.10** | **166.90** | **147.53** | **Services Balance.** |
| Sherbimet Kredi | 303.00 | 397.20 | 628.42 | 1,328.62 | 253.10 | 359.90 | 647.90 | 1,260.90 | Services Credit |
| Sherbimet Debi | -324.15 | -415.77 | -502.24 | -1,242.16 | -272.37 | -360.00 | -481.00 | -1,113.37 | Services Debt |
| **Bilanci i te ardhurave** | **-4.98** | **-4.38** | **-60.73** | **-70.09** | **-19.17** | **-16.10** | **28.90** | **-6.37** | **Balance of Incomes** |
| Te ardhurat Kredi | 63.03 | 63.23 | 51.71 | 177.97 | 62.21 | 79.50 | 70.20 | 211.91 | Income Credit |
